



POLITIKA PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE



PËRMBAJTJA

HYRJE	3
PARIMET	3
PËRKUFIZIME	4
VEPRIME PARANDALUESE	6
1. Burimet njerëzore	6
2. Media & Komunikimi	7
3. Implementimi i aktiviteteve	7
4. Afishimi	8
1. Procedura e trajtimit të dyshimit nga një punonjës ose vullnetar	9
2. Procedura e trajtimit të dyshimit	9



HYRJE

Mirë se vini në politikën për mbrojtjen e fëmijëve dhe procedurat e saj, të cilat vlejné për të gjitha operacionet dhe aktivitetet e kryera nga, apo në emër të, Fondacionit Alo! Mik.

Qëllimi i politikës dhe procedurave është të rregullojnë mënyrën se si ne punojmë si organizatë, në mënyrë që fëmijët me të cilët jemi në kontakt (të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë) të mbrohen dhe të promovohet mirëqenia e tyre dhe që veprimet tona të mos u shkaktojnë ndonjë dëm fëmijëve.

Politika riafirmon dhe përforcon përkushtimin tonë për mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës. Kjo përfshin **veprimet parandaluese** për të minimizuar mundësitë e ndodhjes së dëmit, dhe **veprimet përgjegjëse** për të siguruar që incidentet që mund të ndodhin trajtohen si duhet.

PARIMET

Politika jonë e mbrojtjes bazohet në një numër parimesh dhe besimesh, duke përfshirë:

- **Mosdiskriminimi / Barazia:** të gjithë fëmijët kanë të drejta të barabarta për mbrojtje.
- **Interesi më i lartë i fëmijës:** të gjitha elementet e nevojshme për të marrë një vendim në një situatë specifike për një fëmijë do të vlerësohen dhe do të balancohen.
- **Respektimi i dinjitetit**, nderit dhe personalitetit të fëmijës.
- **Konfidencialiteti:** Privatësia e përfituesit duhet të respektohet dhe informacioni i diskutuar do t'i jepet vetëm kur është e nevojshme ndarja e tij.
- **Përshtatshmëria kulturore:** procedurat dhe proceset duhet të jenë të përshtatshme me kontekstin kulturor dhe social.
- **Puna në partneritet:** Asnjë organizatë e vetme nuk është në gjendje t'i mbrojë fëmijët duke punuar e vetme, prandaj ne do të punojmë me organizata, agjenci të tjera dhe grupe sipas nevojës dhe mënyrës së duhur.

Kjo politikë mbështetet nga:

- Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (1989);
- Ligji Nr.18/2017 “Për Të Drejtat Dhe Mbrojtjen e Fëmijës”



PËRKUFIZIME

Fëmijë – është çdo person nën moshën 18 vjeç. (*Ligji Për Të Drejtat Dhe Mbrojtjen E Fëmijës, 2017*)

Mbrojtja e fëmijës – është parandalimi dhe përgjigjja ndaj dhunës, keqtrajtimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit të fëmijës (*Ligji Për Të Drejtat Dhe Mbrojtjen E Fëmijës, 2017*)

Dhunë ndaj fëmijës – është çdo veprim ose mosveprim me dashje, me anë të të cilit shkaktohet çdo lloj forme dhune fizike ose mendore, lëndimi ose abuzimi, lënia pas dore apo trajtimi neglizhent, keqtrajtimi ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual. (*Ligji Për Të Drejtat Dhe Mbrojtjen E Fëmijës, 2017*)

Abuzimi Fizik – çdo tentativë ose çdo dëmtim fizik apo plagosje e fëmijës, të cilat nuk janë aksidentale dhe që synojnë të shkaktojnë dhimbje ose shqetësim, sado të lehta qofshin këto.

Në abuzimin fizik përfshihen forma të tilla, si: rrahja, tortura, shkundja / shtytja me forcë, djegia, goditja (shuplakë ose shkelm), pickimi, çjerrja, kafshimi, qortimi i rreptë, detyrimi me forcë për të kryer një veprim, përdorimi i lëndëve që shkaktojnë dhimbje ose shqetësim.

Abuzimi Seksual – çdo veprim ose aktivitet seksual për përfitim ose kënaqësi seksuale të abuzuesit – pavarësisht nëse fëmija pranon ose jo.

Abuzim seksual mund të jetë “me kontakt” siç është përdhunimi ose “pa kontakt” si për shembull detyrimi ose inkurajimi i një fëmije për të parë apo për të qenë pjesë e komunikimeve apo materialeve me përmbajtje pornografike.

Abuzimi emocional - është keqtrajtimi i vazhdueshëm emocional i fëmijës në mënyrë të tillë që të shkaktojë efekte të pafavorshme të rënda dhe të vazhdueshme në zhvillimin emocional të fëmijës.

Këtu përfshihet kufizimi i lirisë së lëvizjes, sjellje degraduese, kërcënuese, frikësuese, diskriminuese, përqeshëse ose forma të tjera të trajtimit armiqësor apo refuzues.

Abuzimi shpirtëror - lidhet me abuzimin emocional. Abuzimi shpirtëror mund të përkufizohet si abuzim i pushtetit, i bërë shpesh nën emrin e Perëndisë ose të fesë.

Përfshihet manipulimi ose detyrimi i dikujt për të menduar, thënë ose bërë gjëra pa respektuar të drejtën e individit për të zgjedhur vetë për veten e tij / saj.

Neglizhimi – është mosveprimi me ose pa dashje nga ana e një personi, i cili është përgjegjës për rritjen, përkujdesjen apo edukimin e fëmijës, si pasojë e të cilit rrezikohet jeta, integriteti fizik e mendor dhe zhvillimi i fëmijës



Shfrytëzimi – Kur njëra palë përfiton, financiarisht ose në çdo formë tjetër nga përdorimi i fëmijëve. Kjo përfshin, por nuk kufizohet vetëm në, shfrytëzimin seksual, prostitucionin, punë ose shërbime të detyruara, skllavërinë ose praktika të ngjashme me skllavërinë, robërinë ose heqjen e organeve.

Trafikimi – është çdo veprim ose transaksion, me anë të të cilit fëmija rekrutohet, transportohet, transferohet, fshihet ose merret me anë të kërcënimit apo përdorimit të forcës, apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike, nga një person a grup personash, me anë të shpërblimit ose me qëllim të përfitimit material apo çdo lloj fitimi tjetër, për qëllime të shfrytëzimit.

Abuzimi dixhital- është çdo lloj abuzimi që ndodh në internet, qoftë përmes rrjeteve sociale, duke luajtur lojëra në internet ose duke përdorur telefonat celularë.

Bullizmi kibernetik mund të përfshijë përhapjen e thashethemeve rreth dikujt, ose postimi i mesazheve të këqij ose të turpshëm, imazhe ose video. Grooming është kur dikush ndërton një lidhje emocionale me një fëmijë për të fituar besimin e tyre për qëllime abuzimi seksual, shfrytëzimi seksual ose trafikimi. Kur shfrytëzimi seksual ndodh në internet, fëmijët mund të binden / detyrohen të dërgojnë imazhe seksuale të qarta dhe të hollësishme ose të marrin pjesë në aktivitete seksuale nëpërmjet një kamera webi ose telefoni smart, dhe / ose të kenë biseda seksuale.

Bullizmi - është një sjellje agresive midis fëmijëve të moshës shkollore, i përsëritur ose me potencial për t'u përsëritur, me qëllim dëmtimin. Fëmija, viktimë në këtë rast ka vështirësi për të mbrojtur veten.

Përfshihet:

Bullizëm fizik (goditje të formave të ndryshme, shtytje, pështyrje, grisje të sendeve, libra, shkatërrim librash etj. Bullizëm verbal (sharjet, kërcënimi, përhapja e thashetheme dashakeqe, nofkat ofenduese etj.) Bullizëm social (duke lënë një ose disa nxënës jashtë lojërave apo grupit bashkëmoshatar, duke i shpërfillur apo duke mos i ftuar në festat e klasës apo të shkollës, prishja e miqësisë etj.)



VEPRIME PARANDALUESE

Alo! Mik do të përmbushë angazhimin e tij për të mbrojtur fëmijët përmes:

Ndërgjegjësimit: Duke siguruar që gjithë stafi, vullnetarët dhe të tjerë të jenë të vetëdijshëm mbi problemin e abuzimit me fëmijët dhe rreziqet e fëmijëve.

Parandalimit: Duke siguruar përmes ndërgjegjësimit dhe praktikës së mirë, që stafi, vullnetarët dhe gjithë të tjerët të minimizojnë rreziqet ndaj fëmijëve.

1. Burimet njerëzore

• **Rekrutimi**

Rekrutimi i kujdesshëm dhe i ndjeshëm është me rëndësi madhore kur bëhet fjalë për fëmijët. Procedurat më të sigurta të rekrutimit (punëmarrësi apo vullnetari) përfshijnë veprimet para përzgjedhjes, gjatë përzgjedhjes dhe pas përzgjedhjes, për të siguruar mbrojtjen më të mirë të mundshme. Shih Shtojcën 1 – Lista e plotë për rekrutim më të sigurt.

Puna nuk duhet të fillojë derisa të ndiqen të gjitha proceset për rekrutim më të sigurt dhe derisa të jenë përfunduar kontrollet e dokumentacionit dhe udhëzimi mbi politikën për mbrojtjen e fëmijëve. Megjithatë, pranohet që në disa rrethana përjashtuese mund të ketë vonesë të gjatë, apo për arsye operationale mund të jetë e nevojshme të fillohet puna pas një njoftimi të shkurtër. Në situata të tilla, duhet të ndërmerren masa shtesë që Alo! Mik të mund të ketë besim se rreziqet për fëmijët janë minimizuar sa më shumë të jetë e mundur. Për shembull, ofrimi i mbikëqyrjes shtesë dhe të siguruarit që anëtari në fjalë i stafit nuk punon vetëm.

• **Trajnimi**

Stafi dhe vullnetarët aktivë që punojnë me / për Alo! Mik, duhet të vihen në dijeni për politikën për mbrojtjen e fëmijëve dhe për mënyrën dhe rrugën se si të raportohet një shqetësim.

Gjatë periudhës së tyre të provës, dhe jo më gjatë se tre (3) muaj pas emërimit, gjithë stafit i duhet dhënë këshillim mbi politikën për mbrojtjen e fëmijëve dhe përgjegjësitë e tyre për mbrojtjen e fëmijëve. Vullnetarët aktivë duhet të përfshihen po ashtu në një trajnim të tillë.

Duhet të mbahen të dhënat për të gjitha trajnimet / takimet e mbajtura për të dhënë udhëzime, me datën dhe listën e pjesëmarrësve dhe me firmën përkatëse të çdo pjesëmarrësi.

• **Vullnetarët e rastit dhe vizitorët**

Të gjithë vullnetarët e rastit dhe vizitorët duhet të jenë në dijeni dhe ta kuptojnë Udhëzuesin e Alo! Mik për vullnetarët e rastit dhe vizitorët (Shtojca 2b) dhe të pajtohen qëllimet dhe kushtet para se të bëhet vizita.

Është përgjegjësi e anëtarit të stafit të sigurojë që vullnetarët e rastit dhe vizitorët njoftohen si duhet dhe mbikëqyren gjatë gjithë aktivitetëve apo vizitës dhe se e kanë nënshkruar Udhëzuesin për vullnetarët e rastit dhe vizitorët.

Të gjithë vullnetarët e rastit dhe vizitorët duhet të shoqërohen gjatë gjithë kohës dhe në asnjë rrethanë ata nuk duhen lënë me fëmijët pa u mbikëqyrur.



• **Personi i caktuar për mbrojtjen**

Personi i caktuar për mbrojtjen pranë Fondacioni Alo! Mik është burimi i parë i këshillimit dhe përkrahjes në lidhje me çështjet për mbrojtjen e fëmijëve dhe implementimin e politikës për mbrojtjen e fëmijëve. Personi i caktuar për mbrojtjen duhet të ketë njohje të mirë të politikës së mbrojtjes dhe mënyrës se si ajo vihet në zbatim.

Ai / ajo duhet të marrë pjesë në trajnime, të kuptojë si trajtohen pretendimet dhe ankesat dhe të dijë si t'iu përgjigjet zbulimeve të abuzimeve me korrektësi, në mënyrë të përshtatshme e me ndjeshmëri dhe në përputhje me ligjin në fuqi në Shqipëri.

Ai / ajo sigurohet që çdo staf, vullnetar ose vizitor është i orientuar siç duhet në lidhje me politikën dhe ka firmosur gjithë dokumentet e nevojshme. Ai / ajo duhet të mbajë të dhëna të përditësuara.

Personi i caktuar për mbrojtjen është përgjegjës për gjetjen e emrit dhe të numrit të Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijës (NjMF) në zonën e tyre.

Personi i caktuar për mbrojtjen është:

Emër: Ruth Vergnon Cel: 0694091222

E-mail: ruth.vergnon@alomik.org

2. Media & Komunikimi

Në çdo formë komunikimi, fëmijët duhet të trajtohen dhe prezantohen me dinjitet dhe në një mënyrë që garantohet se siguria e fëmijëve nuk do të rrezikohet.

Mund të gjeni më poshtë disa rregulla etike në lidhje me përdorimin e imazheve:

- Para përdorimit të imazhit, në çdo rast duhet të kërkohet leja me shkrim nga prindi / kujdestari
- Gjithmonë respekto dinjitetin e fëmijëve. Imazhet duhet t'i paraqesin fëmijët në një 'mënyrë pozitive'.
- Të kufizojmë bërjen e fotografive / filmimin vetëm nga një person i caktuar për këtë nga drejtuesi i aktivitetit. Staf, vullnetarët dhe vizitorët inkurajohen t'i 'pëlqejnë' apo 'ndajnë' fotografitë e publikuara në faqet zyrtare të Alo ! Mik dhe në faqet e mediave sociale (si Facebook-u).
- Pamje ose informacione të fëmijëve nuk përdoren për asnjë qëllim tjetër (media sociale...) përtej atyre të negociuar paraprakisht me Alo! Mik. Materialet e vendosura në mediat sociale ose teknologjinë digjitale nuk duhet të përmbajnë kurrë detaje identifikuese si emri, mbiemri ose vendndodhja / adresa personale e një fëmije. Fotografitë jozyrtare nuk duhet të postohen apo transferohen në faqet personale.

3. Implementimi i aktiviteteve

Programet dhe të gjitha llojet e veprimeve në të gjithë sektorët duhet të 'mendojnë për mbrojtjen e fëmijëve' gjithë kohën dhe në të gjitha aktivitetet—dhe jo ta konsiderojnë mbrojtjen si aktivitet të ndarë, por më parë si një temë në vazhdimësi gjatë gjithë punës.



- **Vlerësimi i rrezikut**

Një vlerësim i rrezikut duhet të bëhet për të identifikuar ndonjë rrezik të mundshëm dhe të bëhet një plan për t'i minimizuar këto rreziqe.

- **Mbikëqyrja dhe raportet e stafit**

Fëmijët duhen mbikëqyrur në çdo kohë dhe është detyra e drejtuesit të skuadrës të sigurohet që kjo të jetë e mundur. Raporti i përshtatshëm staf-fëmijë është një mënyrë e efektshme për të minimizuar çdo mundësi që fëmija të lëndohet ose që të ngrihen dyshime kundër një punonjësi. Në përgjithësi, këto janë raportet e sugjeruara për të siguruar mbikëqyrjen e duhur, por varen nga kohe zgjatesia, lloji i aktiviteti dhe nga publiku:

0-2 vjeç	1 punonjës për 4 fëmijë
3-6 vjeç	1 punonjës për 8 fëmijë
7 vjeç e lart	1 punonjës për 12-15 fëmijë

- **Miratimi nga prindi/kujdestari**

Për çdo aktivitet, gjatë të cilit fëmijët janë nën kujdesin dhe mbikëqyrjen e Alo! Mik (p.sh. ekskursione, kampe, takime javore etj.), prindërit duhet të plotësojnë një formular miratimi ku të përfshihen pikat e mëposhtme:

- Informacionet e kontaktit – emri, mbiemri i prindërve dhe numrat e telefonit.
 - Një tjetër emër kontakti dhe numër telefoni, për rastet kur nuk mund të kontaktohen prindërit.
 - Çdo informacion mjekësor / shëndetësor që duhet të dijë stafi, të tilla si alergjitë, kufizimet në dietë dhe mjekimet që merr fëmija.
- Shih modelin e formularit në shtojcën përkatëse.

- **Regjistrimi i incidenteve/aksidenteve**

Stafi përgjegjës për aktivitetin duhet të ketë një regjistër (shtojca 3), në të cilin shënohen të dhëna për incidentet / aksidentet që mund të ndodhin gjatë aktiviteteve me fëmijët / të rriturit e cenusëshëm. Në regjistër shënohen të dhëna si: zënka, prerja, mavijosja, një aksident i ndodhur në tualet, aktivitet, etj. Kur është e nevojshme lajmërohen prindërit/kujdestarët.

Shih modelin në shtojcën përkatëse.

4. Afishimi

Stafi dhe vullnetarët aktivë si dhe partnerët, komunitetet, familjet, fëmijët dhe palët e tjera dhe të gjithë ata që janë në kontakt me Alo! Mik, duhet të vihen në dijeni për politikën për mbrojtjen e fëmijëve, dhe për mënyrën se si të raportohet një shqetësim. Kjo duhet të bëhet në mënyrat që janë të duhura dhe të qasshme duke pasur parasysh kontekstin.

Në të gjitha ambjentet ku Alo! Mik vepron vazhdimisht janë të afishuar :

- Konventa e të Drejtave të fëmijëve, në një gjuhë të përshtatshme për fëmijët.
- Mënyra dhe kontaktet kryesore (NjMF e zonës, Alo 116, Personi i caktuar për mbrojtjen) për raportimin e një abuzimi
- Një prezantim i përgjithshëm i Politikës së mbrojtjes
- Kodi i sjelljes për Mbrojtjen e fëmijëve

Në të gjitha ambjentet ku Alo! Mik vepron vazhdimisht janë të disponueshme :

- Politika e mbrojtjes së fëmijëve
- Udhëzues për vullnetarët e rastit dhe vizitorët
- Formularët e incidentit & raportimit të brendshëm

VEPRIME PËRGJEGJËSE



Nëse ne jemi të përkushtuar për të parandaluar abuzimin dhe për të mbrojtur fëmijët, është thelbësore që stafi, vullnetarët dhe të tjerët të kuptojnë përgjegjësinë e tyre për të ngritur dhe raportuar çdo shqetësim që ata mund të kenë në lidhje me sigurinë e fëmijëve.

Sipas Ligjit Nr 18 / 2017 (neni 67) “Çdo person fizik ose juridik që ka informacion, ose vetë fëmija, duhet të njoftojë për çdo rast të dyshuar apo të ndodhur, abuzimi, neglizhimi apo shfrytëzimi të fëmijës, institucionet qendrore dhe strukturat vendore të mbrojtjes së fëmijës ose Policinë e Shtetit.”

1. Procedura e trajtimit të dyshimit nga një punonjës ose vullnetar

Marrja e deklaratave nga një fëmijë

- Qëndroni të qetë dhe dëgjoni me kujdes çfarë thuhet, mos reagoni në mënyrë të tepruar, mos kritikoni e mos u tregoni gjykues ndaj asaj që thotë fëmija.
- Mos premtoni mbajtje sekrete – shpjegoni se informacione të tilla janë të nevojshme të ndahen, dhe sigurojeni fëmijën se ka bërë gjënë e duhur.
- Lejojeni fëmijën të vazhdojë të flasë / tregojë në ritmin e vet.
- Bëni pyetje vetëm për qartësi dhe shmangni çdo pyetje që mund të sugjerojë një përgjigje të caktuar.
- Tregojini fëmijës (duke konsideruar gjithmonë moshën e tij) çfarë do të bëni në vijim dhe me kë do ta ndani informacionin, duke i shpjeguar rolin e tij si dhe çfarë mund të bëjë. Incidenti nuk duhet të diskutohet me askënd tjetër që nuk ka lidhje me rastin.
- Siguria e fëmijës është kryesore. Nëse fëmija ka nevojë për vëmendje urgjente mjekësore telefono urgjencën mjekësore, informoni mjekët për shqetësimin dhe sigurohuni se ata janë bërë të vetëdijshëm se kjo është një çështje për mbrojtjen e fëmijës;
- Regjistrojini me shkrim fjalët e thëna sa më shpejt të jetë e mundur, duke përdorur fjalët e fëmijës, nëse është e mundur. Mbani shënim kohën, datën dhe emrat e ndryshëm që përmenden. Firmoseni dokumentin dhe shënoni në të datën.

Shqetësimi duhet që të raportohet menjëherë në fillim verbalisht dhe me shkrim duke plotësuar formularin e raportimit të brendshëm (Shtojca 6- Pjesa I), pranë menaxherit të sektorit ose pranë Drejtorit Ekzekutiv në rast se menaxheri është i përfshirë, në mënyrë që të diskutohet për veprimet e mëvonshme (në po atë ditë).

Çdo lloj shqetësimi, supozimi, dhënie informacioni duhet të shkruhet në kohën që thuhet ose sa më shpejt të jetë e mundur pasi është ngritur shqetësimi, dhe jo më vonë se 24 orë. Regjistrimi i të dhënave duhet të jetë sa më i detajuar dhe i saktë të jetë e mundur, duke dhënë saktësisht informacionin e asaj që është thënë ose vëzhguar.

*Raportimi i brendshëm nuk përjashton **përgjegjësinë individuale** të punonjësit ndaj detyrimit ligjor për raportimin.*

2. Procedura e trajtimit të dyshimit

• Çështja e jashtme

Çështja e jashtme ka të bëjë me abuzim të mundshëm, aktual apo të dyshuar të një fëmijë nga familja / komuniteti ose nga persona të jashtëm për Alo! Mik.

Në këtë rast, menaxheri i sektorit në bashkëpunim me personin e caktuar për mbrojtjen, me përkrahjen e Drejtorit Ekzekutiv, duhet t'ia raportojë rastin Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijës (NjMF - e cila duhet të gjendet pranë çdo bashkie / komune / njësie

Fondacioni Alo ! Mik

www.alomik.org info@alomik.org p.9



administrative), duke plotësuar formularin e përshtatshëm Shtojca 7). Raportimet në NjMF duhen bërë brenda 24 orësh nga identifikimi i rastit, ose ditën vijuese të punës.

Në rastin kur fëmija është në rrezik të drejtpërdrejtë (situatë emergjente), policia duhet të kontaktohet e para dhe pak më pas NjMF në mënyrë që të garantohet siguria e fëmijës duke e vënë atë nën mbrojtje të menjëhershme.

Në rastin kur identifikimi bëhet gjatë një aktiviteti të zhvilluar në partneritet me një aktor tjetër, atëherë trajtimi i dyshimit bëhet në bashkëpunim me personin e caktuar për mbrojtjen ose me personin përgjegjës pranë partnerit.

- **Çështja e brendshme**

Kur dyshimi përfshin stafin ose vullnetarin e Alo! Mik do të vepohet si më poshtë :

- (i) Personit i duhet hequr menjëherë mundësia e kontaktit me fëmijët, derisa çështja të jetë zbardhur (në këtë rast menaxheri i sektorit ka përgjegjësi të plotë).
- (ii) Menaxheri i sektorit lajmëron menjëherë Drejtorin Ekzekutiv.
- (iii) Ai / Ajo realizon një vlerësim të brendshëm, në bashkëpunim me personin e caktuar për mbrojtjen edhe me përkrahjen e Drejtorit Ekzekutiv.
- (iv) Drejtori Ekzekutiv i dërgon Pjestarëve të Bordit një raport me shkrim.
- (v) Nëse, pas vlerësimit, shqetësimi ka të ngjarë të jetë vepër penale do të ndërmerren veprime disiplinore të brendshme dhe do të përfshihen autoritetet përkatëse si në rastin e shqetësimit të jashtëm.
- (vi) Nëse, pas vlerësimit shqetësimi ka të bëjë vetëm me shkeljen e politikës për mbrojtjen e fëmijëve do të ndërmerren veprime disiplinore të brendshme.

Kur dyshimi përfshin një person në pozicion e drejtimit (Drejtori Ekzekutiv ose Pjesëtar të Bordit) lajmërohet Bordi i Fondacionit nëpërmjet Elton Prifi (toni.fiduciary@gmail.com, 0692077838), duke dërguar gjithashtu sa më parë formularin e raportimit të brendshëm.

Në çdo rast, procedurat e ndërrmarra do të dokumentohen dhe do të ruhen në një dosje konfidenciale pranë zyrës qendrore.



DEKLARIM PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE

Unë.....

(lexoni me kujdes deklaratat e mëposhtme dhe shënoni me një x nëse jeni dakord)

- nuk jam akuzuar asnjëherë për sjellje të papërshtatshme me një fëmijë dhe nuk kam një të kaluar kriminale dhe mund ta vërtetoj me një dëshmi penaliteti.
- kam lexuar Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve të Alo! Mik-ut dhe jam dakort të përmbush të gjitha udhëzimet dhe procedurat e saj.
- e di se personi, të cilit duhet t'i raportoj çështjen, duke përdorur formularin e raportimit të brendshëm, është
- jam plotësisht i vetëdijshëm mbi rëndësinë e mos mbajtjes së ndonjë informacioni mbi çdo lloj abuzimi, që një fëmijë nën përgjegjësinë time ka pësuar apo është duke pësuar.
- e kuptoj se çdo sjellje diskriminuese, fyese, e dhunshme ose jashtë frymës së Politikës së Mbrojtjes, është e papranueshme dhe se zbulimi dhe raportimi i saj do të rezultojë në marrjen e masave. Këtu mund të përfshihen pezullimi ose mbyllja e përfshirjes me Alo! Mik dhe / ose masa penale, sipas legjislacionit në fuqi në Shqipëri.
- bie dakort që është përgjegjësia ime që të ruaj konfidencialitetin e të gjithë informacionit që ka të bëjë me një dyshim, apo fakt abuzimi të një fëmije, vetëm në rast informacioni të kufizuar tek persona, tek të cilet duhet të jap informacionin në përputhje me kërkesat e procedurës.

Vendi.....

Data.....

Emri, Mbiemri.....

Firma.....

Shtojca 1 – Lista e plotë për rekrutim më të sigurt

Këto udhëzime janë përgatitur për të siguruar një rekrutim më të sigurt.

Është e njohur se rekrutimi kurrë nuk mund të jetë plotësisht ‘i sigurt’. Qëllimi i rekrutimit më të sigurt është të përcaktohen një numër veprimesh që, në tërësi, kanë për synim t’i zvogëlojnë mundësitë e punësimit të personit ‘të gabuar’.

Para fillimit të punës ose aktivizimit duhen siguruar dokumentet edhe duhet organizuar orientimi si më poshtë.

Të punësuarit	Dokumente	Dëshmi penaliteti Referenca profesionale dhe shpirtërore Politika e mbrojtjes e firmosur Kodi i sjelljes
	Orientim	Trajnim (1 orë ½) ose orientim individual (45 min), brenda 3 muajve të parë
Vullnetarët aktivë	Dokumente	Dëshmi penaliteti Formular aplikimi (shtojca 9) Kodi i sjelljes (Shtojca 2a) Leje e prindërve (për minorenë)
	Orientim	Trajnim (1 orë në grup) ose orientim individual (30 min)
Vullnetarët e rastit dhe vizitorët	Dokumente	Udhëzuesi i vullnetarëve të rastit dhe vizitorëve (Shtojca 2b)
	Orientim	Orientim (10 min) në bazë të udhëzuesit



Shtojca 2a– Kodi i sjelljes për stafin & vullnetarët

Alo! Mik e merr seriozisht mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve. Alo! Mik i konsideron të gjitha format e abuzimit ndaj fëmijëve të jenë të papranueshëm dhe pranojnë se ka për detyrë të mbrojtë fëmijët - domethënë t'i mbajnë ato të sigurt, të promovojnë mirëqenien e tyre dhe t'i mbrojnë ata nga abuzimi dhe dëmtimi. Neglizhimi, dhuna fizike, psikologjike / emocionale, shpirtërore dhe seksuale janë format kryesore të abuzimit.

Si pjesë e politikës sonë të mbrojtjes së fëmijëve, është një kërkesë që të gjithë stafin (duke përfshirë punonjësit, vullnetarët, konsulentët dhe praktikantët), partnerët dhe grupet e pritura nga Alo! Mik, të respektojnë kodin e sjelljes, i cili përcakton përgjegjësitë për ruajtjen e fëmijëve dhe sjelljen e pritshme të stafit. KJO ËSHTË NJË KËRKESË E DETYRUESHME.

Të gjithë personat që punojnë me Alo! Mik në çfarëdo përgjegjësie dhe pavarësisht nëse paguhet ose jo, janë të shtrënguar nga kushtet e Politikës së Mbrojtjes. Këto masa, po ashtu, mbrojnë vullnetarët dhe vizitorët nga veprimet që mund të keqinterpretohen dhe çojnë në akuzime. Ne duam që ju të na ndihmoni që t'i mbajmë fëmijët të sigurt duke ju informuar me elementet kryesore të politikës tonë që ju prekin juve si një vullnetar.

Duke firmosur këtë formular, ju bini dakord të punoni brenda kushteve të kësaj politike dhe udhëzimeve vijuese për sjelljen.

Në mënyrë specifike, për të garantuar sigurinë e fëmijëve dhe të të rinjve, UNË DO TË:

- Marr pjesë në çdo trajnim / orientim që më ofrohet në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve;
- Trajtoj të gjithë fëmijët dhe të rinjtë me barazi dhe respekt, dinjitet dhe ndjeshmëri, në sjellje, gjuhë dhe veprime;
- Garantoj sigurinë duke qenë i / e përgatitur e duke vlerësuar mjediset fizike ku do të jenë të pranishëm fëmijët;
- Punoj në një mjedis të hapur duke shmangur situatat private ose pa vëzhgim;
- Mbaj kufij fizikë të sigurt e të përshtatshëm me fëmijët;
- Kërkoj të përdor metoda pozitive për disiplinimin dhe kontrollin e fëmijëve;
- Raportoç çdo shqetësim, sado i paqartë, në lidhje me mirëqenien e fëmijëve ose sjelljen e një të rrituri, duke e sjellë në vëmendjen e Alo ! Mik; dhe,
- Kërkoj drejtim e mbështetje nga Alo ! Mik sa herë nuk jam i / e sigurt për rolin dhe përgjegjësitë e mia ose për mënyrën më të mirë të veprimit.

Në mënyrë specifike, UNË KURRË NUK DO TË:

- Veproç në mënyra që synojnë të turpërojnë, poshtërojnë ose të degradojnë fëmijët;
- Përdor asnjë formë të abuzimit emocional/fizik/shpirtëror/seksual si (por pa u kufizuar në):
 - Përdor ndëshkim trupor / fizik të asnjë lloji, as ndonjë lloj disiplinimi psikologjik ose emocional;
 - Përdor asnjë lloj presioni apo manipulimi emocional apo shpirtëror për të ndikuar tek fëmijët në zgjedhjet e tyre;
 - Përfshihem në lojëra ose aktivitete që janë fizikisht ose seksualisht provokuese ose të bërit e komenteve seksualisht sugjестive ndaj / përpara një fëmije, as për argëtim;
 - Lejoj ose përfshihem në asnjë formë prekjeje/përqafimi të papërshtatshëm të fëmijëve;



- Përdor gjuhë të papërshtatshme përpara fëmijëve, as t'i lejoj fëmijët të përdorin gjuhë të papërshtatshme;
- Bëj fëmijët objekt shakaje ose t'i paraqes në mënyrë poshtëruese para të tjerëve;
- Shpërndaj dhurata, ëmbëlsira ose para pa e diskutuar paraprakisht këtë;
- Krijoj marrëdhënie me fëmijët jashtë punës të shkëmbej të dhënat personale me fëmijët;
- Kthehem në komunitet pa e diskutuar më parë me udhëheqja e Alo! Mik;
- Bëj fotografi ku fëmijët duken të veshur në mënyrë minimale ose aspak, ose që mund të konsiderohen poshtëruese;
- Përdor pamje të fëmijëve ose informacion për asnjë qëllim tjetër (media sociale...) përtej atyre të negociuara paraprakisht me Alo! Mik dhe me miratimin e fëmijëve dhe familjeve të tyre;
- Bëj pyetje të bezdisshme e private në lidhje me çështje të ndjeshme, përveçse nëse janë diskutuar paraprakisht, në mënyrë që të jetë vendosur mbështetja e përshtatshme.

Unë e kuptoj se çdo sjellje diskriminuese, fyese, e dhunshme ose jashtë frymës së Politikës së Mbrojtjes, është e papranueshme dhe se zbulimi dhe raportimi i saj do të rezultojë në marrjen e masave. Këtu mund të përfshihen pezullimi ose mospërfshirja me Alo ! Mik dhe/ose masa penale.

Gjithashtu, unë deklaroj se:

- Nuk jam dënuar kurrë për sjellje të papërshtatshme me fëmijët dhe nuk kam precedentë penalë, gjë që mund ta vërtetoj me anë të dëshmisë së penaltetit.
- Jam plotësisht i / e ndërgjegjshëm /me për rëndësinë e mosfshehjes së informacionit mbi çfarëdo abuzimi që fëmijët të cilët kanë qenë nën përgjegjësinë time kanë vuajtur ose po vuajnë. Unë e di edhe se personi tek i cili duhet të raportoj çdo dyshim, në fillim në mënyrë verbale e më pas duke përdorur formularin e raportimit të brendshëm, është
- Bie dakord se është përgjegjësia ime të ruaj në mirëbesim çdo informacion që ka të bëjë me një dyshim ose abuzim real të një fëmije, përveçse nëse informacioni është i kufizuar për personat që duhet ta ofrojnë atë në përputhje me kërkesat e procedurës.

Emër, Mbiemër, Firmë.....

Data.....



Shtojca 2b– Udhëzuesin e Alo! Mik për vizitorët

Alo! Mik e merr seriozisht mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve. Të gjithë personat që punojnë me Alo! Mik në çfarëdo përgjegjësie dhe pavarësisht nëse paguhen ose jo, janë të shtrënguar nga kushtet e Politikës së Mbrojtjes. Këto masa, po ashtu, mbrojnë vullnetarët dhe vizitorët nga veprimet që mund të keqinterpretohen dhe çojnë në akuzime qëllimkëqija.

Ne duam që ju ta pëlqeni punën / vizitën tuaj dhe në të njëjtën kohë të na ndihmoni që t'i mbajmë fëmijët të sigurt duke ju informuar me elementet kryesore të politikës tonë që ju prekin si një vullnetar apo vizitor.

Duke firmosur këtë formular, ju bini dakord të punoni brenda kushteve të kësaj politike dhe udhëzimeve vijuese për sjelljen.

Komunikimet dhe mbrojtja e fëmijëve

Për t'u siguruar që ne e minimizojmë rrezikun që të krijohen raporte të dëmshme, korrespondenca ndërmjet vizitorëve dhe fëmijëve dekurajohet dhe nëse paraqitet nevoja ajo duhet dërguar përmes Alo! Mik për monitorim më parë sesa drejtpërdrejt fëmijës. Vullnetarët nuk duhet të krijojnë marrëdhënie të veçanta me fëmijët dhe t'i inkurajojnë këto të zhvillohen jashtë ambientit normal të punës. Vizitorët nuk duhet të shkëmbejnë detajet për kontakt kur takojnë fëmijët dhe të rinjtë.

Të gjitha mundësitë e vullnetarizmit dhe vizitat në projekte duhet të rregullohen zyrtarisht, me lejen e Përfaqësuesit të Alo! Mik.

Fotografitë, videot dhe imazhet e tjera–Praktika e mirë

Në çdo formë komunikimi, fëmijët duhet të trajtohen dhe prezantohen me dinjitet dhe jo si viktima të pashpresa apo në poza me nënkuptime seksuale.

Teknologjia e ka lehtësuar përdorimin e fotografive dhe imazheve, si të shtypura në letër, ashtu edhe për faqe interneti. Rritja e përdorimit do të thotë përgjegjësi më e madhe për të siguruar mbrojtjen e drejtave dhe sigurisë së personave të përfshirë në imazhe.

Para përdorimit të imazhit, në çdo rast duhet të kërkohet leja me shkrim nga fëmija dhe prindi.

Përdorimi i imazheve të fëmijëve (në media sociale, për përfitim financiar apo për qëllime gazetarie) nuk lejohet pa lejen e Alo! Mik

Udhëzim për sjellje të përgjegjshme

Si vullnetar i rastit i Alo! Mik apo vizitor UNË DO TË:

- Caktoj gjithmonë vullnetarizmin / vizitën time përmes Alo! Mik.
- Ndjek drejtimet dhe udhëzimet e anëtarit të stafit të Alo! Mik, i cili është caktuar për të mbikëqyrur punën time apo të më shoqërojë mua në vizitë.
- Diskutoj çdo shqetësim që kam lidhur me mirëqenien e fëmijës me anëtarin e stafit të Alo! Mik / personin kontaktues për mbrojtjen e fëmijëve.
- Pyes anëtarin e stafit të Alo! Mik, kur nuk jam i sigurt se çfarë është sjellja e pranueshme.

UNË KURRË NUK DO TË:

- Përdor gjuhën, jap sugjerime apo ofroj këshillë që është jo e duhur, fyese apo abuzive.
- Sillem fizikisht në një mënyrë që është jo e duhur apo seksualisht provokative. Për shembull: të ledhatoj, mbaj, përqafoj, puth apo prek fëmijët në një mënyrë që është jo e duhur apo e ndjeshme në aspektin kulturor.
- Lejoj apo marrë pjesë në një sjellje me fëmijët që është ilegale, e pasigurt apo abuzive.



- Veproj në mënyra që kanë për qëllim të turpërojnë, poshtërojnë, nënvlerësojnë apo degradojnë fëmijët apo angazhohem në ndonjë formë të abuzimit emocional apo godas fizikisht një fëmijë.
- Diskriminoj, bëj trajtim sipas preferencës, apo favorizoj fëmijët e caktuar duke përjashtuar të tjerët.
- Hyj në marrëdhënie fizike dhe / apo seksuale me fëmijët apo anëtarët e tyre të familjes.
- Krijoj marrëdhënie me fëmijët të cilat në çfarëdo mënyre do të mund të konsideroheshin shfrytëzuese apo abuzive.
- Kaloj kohën vetëm me fëmijët larg prej të tjerëve.
- Ndihmoj fëmijët të largohen nga komuniteti i tyre, madje edhe me pëlqimin e prindërve / kujdestarëve, apo ofroj fëmijëve rastin të vizitojnë vendin tim të banimit.
- Shkëmbej detajet e kontakteve personale me fëmijët.
- Caktoj të qëndrojë tërë natën me fëmijët apo familjen e tyre.
- Kthehem në komunitet pa respektuar / ndjekur procesin e vizitës së zakonshme me Alo! Mik.

Unë konfirmoj se e kam lexuar dhe kuptuar Udhëzuesin për vullnetarët e rastit dhe vizitorët dhe pajtohem të veproj në pajtim me përmbajtjen e tij.

Vendi.....Data.....

Emri, Mbiemri.....

Firma.....



Shtojca 3 – Regjistrimi i incidenteve / aksidenteve

· Incident · Aksident

Emri i fëmijës:Data e aksidentit/incidentit: / /

Vendi ku ndodhi aksidenti/incidenti:

.....

Emri i anëtarit të stafit të pranishëm:

.....

Emrat e dëshmitarëve të rritur (nëse ka):

.....

.....

Çfarë ndodhi?

.....

.....

.....

.....

.....

A kishte nevojë për përkujdesje mjekësore? · Po · Jo

Nëse po, çfarë trajtimi mori fëmija?

.....

A ka nevojë për përkujdesje të mëtejshme mjekësore? · Po · Jo

A u njoftua prindi / kujdestari? · Po · Jo

A nevojitet ndjekje e mëtejshme e rastit? · Po · Jo

Nëse po, çfarë lloj ndjekjeje nevojitet?

.....

Anëtari i stafit i pranishëm


Emri, Mbiemri dhe Firma

Personi përgjegjës i aktivitetit

Emri, Mbiemri dhe Firma



Shtojca 4a– Mënyra e raportimit dhe kontaktet kryesore



Personi i caktuar për Mbrojtjen / 069 40 91 222



Ndalo dhunën!

Fëmijët kanë të drejtë të mbrohen ndaj të gjitha formave të dhunës. Por disa herë fëmijët mund të lëndohen në mënyra të ndryshme.



Abuzimi fizik

Nëse dikush të shkul veshët,
të pïckon fort, të godet...



Abuzimi Emocional

Nëse dikush të bërtet shpesh, të
poshtëron ose të kërcënon...

Abuzimi Seksual

Nëse dikush të prek në një mënyrë që të
vendos në siklet, ose në zonat intime...



Shfrytëzimi

Nëse dikush të kërkon të lypësh, ose të
punosh në vend që të shkosh në shkollë...

Bullizmi

Nëse shokët të kërcënojnë ose sillen
me ty në mënyrë agresive vazhdimisht...

Dhuna është gjithmonë gabim dhe duhet të ndalohet.



Mos hezito ti tregosh një personi të besueshëm
si prindit, mësuesit, kujdestarit ose
punonjësit për Mbrojtjen e fëmijëve.

Ose



Telefono në çdo kohë te 166111





Mbrojtja e fëmijëve



Alo! Mik e merr seriozisht mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve. Të gjithë personat që punojnë me Alo! Mik në çfarëdo përgjegjësie janë të shtrënguar nga kushtet e Politikës së Mbrojtjes së fëmijëve.

Çfarë është Politika e Mbrojtjes?

Një dokument dhe një procedurë që një organizatë duhet të përgatisë dhe të zbatojë për të ndihmuar në parandalimin dhe përgjigjen ndaj abuzimit të mundshëm të fëmijëve.



Ka si qëllim:

- të mbrojë stafin nga akuza të rreme që mund të ngrihen kundër tyre,
- t'i mësojë stafit parimet që duhen zbatuar e të cilave duhet t'u përmbahet kur flitet për sigurinë dhe mbrojtjen e fëmijëve,
- të mësojë stafin se si mund të sillen me fëmijët që u tregojnë atyre për një incident abuzimi,
- t'i mësojë stafit hapat që duhen marrë për të raportuar dyshimet për një incident abuzimi.

Çfarë përmban Politika e Mbrojtjes?

- Përkufizime dhe kuadri ligjor
- Parime (interesi më i lartë i fëmijëve, konfidencialiteti...)
- Udhëzime praktike për veprime parandaluese dhe përgjegjëse



Rekrutimi



Kodi i sjelljes



Komunikim



Raportimi

Për më shumë informacion, mund të kërkonj një kopje të Politikës sonë pranë menaxherit.



Shtojca 6 – Formulari i raportimit të brendshëm

PJESA 1: RAPORTIMI

Ky formular duhet plotësuar në rast shqetësimi / dyshimi në lidhje me sigurinë e fëmijëve, në kuadër të mbrojtjes së tyre ndaj dhunës.

Data:

Vendi:

Dyshimi i ngritur

Niveli i dyshimit: i ulët mesatar i lartë

Lloji i abuzimit:

seksual fizik emocional shpirtëror neglizhim
 shfrytëzim tjetër:

Arsye për raportim:

Personi që raporton dyshimi

Staf i A!M Vullnetar i A!M Partner Tjetër

Emër, Mbiemër:

Mosha: Gjni: Profesion:

Cel:

Lidhje me A! M:

Lidhje me viktimën:



Viktima

Përfituesi i A! M Përfituesi i partnerit Tjetër:

Emër, Mbiemër:

Mosha:

Gjinia:

Të dhënat mbi familjen:

Abuzues i supozuar

Staf i A! M Vullnetar i A! M Partner Familjar
 Tjetër:

Emër, Mbiemër:

Mosha:

Gjinia:

Profesioni:

Lidhje me A! M:

Lidhje me viktimën:

PJESA 2: MASAT E NDËRMARRA

Për të mbrojtur fëmijën (përkujdesje, raportimi,...)

Për të shmangur një abuzim tjetër nga abuzuesi i supozuar
(masat paraprake...)



Informacione shtesë

A është folur me fëmijën? Po Jo
Nëse po, çfarë është thënë?

A janë kontaktuar prindërit? Po Jo
Nëse po, çfarë është thënë?

A është marrë këshilla e dikujt tjetër? Po Jo
Nëse po, çfarë është biseduar?

A ka një veprim tjetër që duhet ndërmarrë? Po Jo
Nëse po nga kush dhe kur?

Kush do të bëjë ndjekjen e rastit Brenda A! M dhe si?

Mbyllja e rastit

Arsyeja e mbylljes:

Data e mbylljes:



Shtojca 7 –Formulari i Raportimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje

FORMULARI I RAPORTIMIT TË FËMIJËS NË NEVOJË PËR MBROJTJEN		
Emri /identiteti i fëmijës:	Data e lindjes:	Gjinia:
Emri dhe adresa e prindit/e kujdestarit:	Vendndodhja e fëmijës/adresa ku po qëndron fëmija:	
Shenjat e abuzimit/neglizhimit/dhunës së mundshme <i>(shenja fizike, sjellja e fëmijës, informacione të tjera mbi gjendjen e fëmijës):</i>	Lloji i abuzimit i dyshuar/konstatuar: <input type="checkbox"/> dhunë fizike <input type="checkbox"/> dhunë seksuale <input type="checkbox"/> dhunë psikologjike <input type="checkbox"/> shfrytëzim ekonomik <input type="checkbox"/> trafikim <input type="checkbox"/> fëmijën në situatë rruge <input type="checkbox"/> neglizhim	

Të dhëna të tjera mbi situatën e fëmijës:

Përmbledh informacione të tjera që sugjerojnë se fëmija është në situatë rreziku dhe burimin e rrezikut.

Arsyet për raportim: Shqetësimi për mbrojtjen e fëmijës:

Emri dhe detajet e kontaktit të personit që ka bërë identifikimin:	Emri dhe detajet e kontaktit të personit që bën raportimin:	
Firma	Emri dhe kontaktet e personit/institucionit, të cilit i dërgohet formulari:	Formulari është dërguar: - Email: nga adresa _____ - Postë: Data:



Shtojca 8a –Miratimi i prindërve

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

xxxxxx

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Emër, Mbiemër

Gjinia Datëlindja

Atësia.....

Numër telefoni i prindit.....

Kontakt tjetër në rast emergjence.....

TË DHËNA MJEKËSORE

Prindër! Ju jeni të vetmit që e njihni më mirë fëmijën tuaj, ndaj lutemi me qëllim mirëqenien e fëmijës tuaj, të jeni të kujdesshëm për të vendosur nëse fëmija juaj është në gjendje shëndetësore të frekuentojë aktivitetin.

Detaje të ndonjë problemi mjekësor që duhet ta dimë (alergji, astma, diabet, epilepsi)

.....
.....
.....

Ndonjë kurim / ilaç specifik që duhet ta marrë në një orë të caktuar gjatë:

.....
.....

MIRATIMI

Mbasi mora informacionin e nevojshëm, me anë të këtij dokumenti:

Unë jap lejen që fëmija im të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet sipas përshkrimit më sipër.

Unë konfirmoj se fëmija është me shëndet të mjaftueshëm për të marrë pjesë në aktivitet. Unë pranoj që në rast të një sëmundje ose aksidenti Alo! Mik do të kërkojë të kontaktojë prindin apo personin nëpërmjet të dhënave të mësipërme dhe në rast emergjence mund të shoqërojë fëmijën time në urgjencë. Unë e kuptoj që nëse ka ndonjë kosto mjekësore mua mund të më kërkohet që të kontribuoj.

Unë bie dakort që fotografitë e fëmijës tim të përdoren:

- në komunikime të brendshme të Alo! Mik Po Jo
- në media sociale, në një formë jo identifikuese Po Jo



Emër, Mbiemër i prindit:

Data dhe Firma:

Shënim (nëse keni) :

Kur anëtarët e familjes janë analfabetë, kjo formë mund të nënshkruhet në emër të tyre nga një anëtar i stafit / vullnetar, duke siguruar që përmbajtja e formularit të diskutohet me anëtarët e familjes dhe ata japin pëlqimin verbal të veçantë. Duke nënshkruar formularin, anëtari / vullnetari i personelit konfirmon se ata kanë kërkuar dhe marrë leje.



Shtojca 8b –Miratimi i prindërve-media specifike

Kjo formë plotësohet kur fotoja, historia ose videoja e një fëmije do të përdoret për një rast të veçantë si publikimi tek një publik i hapur.

Kur anëtarët e familjes janë analfabetë, kjo formë mund të nënshkruhet në emër të tyre nga një anëtar i stafit / vullnetar, duke siguruar që përmbajtja e formularit të diskutohet me anëtarët e familjes dhe ata japin pëlqimin verbal të veçantë. Duke nënshkruar formularin, anëtari / vullnetari i personelit konfirmon se ata kanë kërkuar dhe marrë leje.

Për prindërit:

Unë bie dakort/ nuk bie dakort (rretho një të një prej zgjedhjeve) për fëmijën tim dhe për veten time, të marrim pjesë në aktivitetet e medias në lidhje me _____ [SHKRUAJ EMRIN E NGJARJES / PROGRAMIT], përfshirë botimin e fotografive, imazheve dhe tregimeve tona në gazeta, raporte dhe në internet. Unë e kuptoj se edhe nëse nuk jap leje për përfshirjen në media, fëmija im ende mund të marrë pjesë në aktivitete.

Emri i fëmijës

Emri i prindërve

Firma.....

Data.....

Për fëmijën:

Unë bie dakort / nuk bie dakort (rretho një të një prej zgjedhjeve) që nëse prindërit kanë rënë dakort, të marr pjesë në aktivitetet e medias në lidhje me _____ [SHKRUAJ EMRIN E NGJARJES / PROGRAMIT], përfshirë botimin e fotografive, imazheve dhe tregimeve tona në gazeta, raporte dhe në internet. Unë e kuptoj se edhe nëse nuk jap leje për përfshirjen në media, fëmija im ende mund të marrë pjesë në aktivitete.

Emri

Firma.....

Data.....



Shtojca 9 – Formular aplikimi për vullnetar

Informacion personal

Emri, Mbiemri

Datëlindje

Adresa

Celular

Kisha

Situata (student, apo profesion)

A jeni, apo keni qenë të akuzuar më pare për një krim të ndëshkuar nga ligji shqiptar? Dorëzoni bashkë me këtë formular një dëshmi penaliteti)

Nëse po, shpjegoni :

.....

Jeta e krishterë

1 .Shkruani shkurt dëshminë rreth jetës suaj në besim.

.....

.....

.....

.....

.....

.....

Interesa dhe aftësi personale

1. Çfarë lloj eksperience keni me fëmijët?

.....

.....

.....

.....



2. Bëni një listë me çdo lloj formimi, shkolle apo stazhi që keni kryer që ju ka përgatitur për të shërbyer me fëmijët.

.....

.....

.....

.....

3. Cili është qëllimi juaj për të qënë pjesë e kampeve ?

.....

.....

.....

.....

Personi që rekomandon : drejtuesi i kishës

Emri, Mbiemri

Telefoni

Unë deklaroj se informacionet e dhëna më sipër janë të sakta dhe korrekte për sa e njoh personin dhe jam dakort që personi të marrë pjesë në një ose disa kampe të organizuar nga Alo! Mik.

Rekomandim :

.....

.....

.....

.....

Firma e pastorit/e personit qe rekomandon

Data Firma e aplikantit